VENDIM
Nr. 102, datë 18.8.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) VERSIONI 1.2

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO),

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës se koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft "Rregullat e ankandit versionin 1.2" në gjuhën origjinale angleze dhe të përkthyera në gjuhën shqipe.
2. Në çdo rast mosmarrëveshjesh, palët do t`i referohen versionit origjinal të "Rregullave të ankandit versionin 1.2" në gjuhën angleze, për interpretim.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti